

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
5SC-A**

**Neni 1 - Emri**

1.1 Shoqëria krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është 5SC-A, më poshtë do të quhet "Shoqëria".

**Neni 2 - Themelimi**

2.1 Shoqëria themelohet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtare Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin Shqiptar, me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

**Neni 3 - Selia**

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Benjamin Kruta, Fusha e Aviacionit, Pallati E.J.A STUDIO, shkalla 1, kati 3, njesia 12, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë.

**Neni 4 - Ortaku i Vetëm**

4.1 Ortaku i vetëm i Shoqërisë është:

- Z. Julian Çuko, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 14.04.1981, mbajtës i leternjoftimit nr. 033694434, me adresë në: Rruga Benjamin Kruta, Fusha e Aviacionit, Pallati E.J.A STUDIO, shkalla 1, kati 3, njesia 12, Tiranë, Shqipëri.

**Neni 5 - Kapitali Themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 3,660,000.00 (tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë leke) Lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale prej 3,660,000.00 (tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë leke) Lekë, e cila përfaqëson 100 % (njëqind për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar dhe zotërohet plotësisht nga Ortaku themelues Z. Julian Çuko, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 14.04.1981, mbajtës i leternjoftimit nr. 033694434, numër personal I10414212L me adresë në: Rruga Benjamin Kruta, Fusha e Aviacionit, Pallati E.J.A STUDIO, shkalla 1, kati 3, njesia 12, Tiranë, Shqipëri, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

5.2 Kuotat, me vendim të Ortakut të Vetëm, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër të parashikuar nga ligji.

**Neni 6 - Objekti**



6.1 Objekti i Shoqërisë është Projektim, arkitekture, konstruksion, zbatim i tyre. Ndertime civile dhe ekonomike. Ndertime industrial, turistike, bujqesore, etj, mbi 2 kate dhe kompletim me instalimet e nevojshme per to. Studim, projektim, financim, menaxhim, administrim i ndertimeve civile, ekonomike, socialkulturore, ushtarake, portuale, shtepi banime, infrastructure, rruge, ura, parqe industrial etj. Ndertime vepra arti rrugore dhe hekurudhore. Ndertime detare dhe hidroteknike. Punime restaurimi, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike etj. Prodhim dhe tregetim, import eksport mobiljesh, te lendeve te drurit. Shoqeria mund te zhvilloje gjithashtu cdo aktivitet tjetër plotesues e ndihmes qe rezulton i dobishem dhe/ose i nevojshem per permbushjen e objektit kryesor, duke perfshire tregtimin e produkteve dhe kryerjen e sherbimeve te tjera. Me qellim realizimin e objektit te saj, me vendim te organit vendimmarres, Shoqeria mund te zoteroje ne menyre direkte apo indirekte, aksione apo pjesemarrje ne shoqeri te tjera shqiptare dhe/ose te huaja. Shoqeria, me vendim te organit vendimmarres, me qellim realizimin e objektit te saj, mund te marre pjese ne cfaredo lloj marreveshje tregtare dhe/ose joint venture me shoqeri te tjera e sipermarrje, si edhe te kryeje çdo akt tjetër te nevojshem. Shoqeria, me vendim te organit vendimmarres, mund te lidhe kontrata qiraje, shitblerje, marreveshje per vendosje hipoteke mbi pasuri te paluajtshme, marreveshje huadhenie apo financimi, marreveshje per ofrimin e sherbimeve dhe cdo marreveshje tjetër qe konsideron te nevojshme per permbushjen e objektit te saj. dhevajrave heterike). Import eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te rrobave te gatshme, tekstile, metrazhe etj. Import - eksport i aparaturave imazherike dhe aksesoreve te tyre, apartatura dentare dhe aksesore, aparatura laboratorike si dhe hapjet e depova farmaceutike, ofrimi i sherbimeve nderhyrese higjeno-sanitare si dezinfektim dhe procese te tjera.

6.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm.

### **Neni 7 - Kohëzgjatja**

7.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### **Neni 8 - Kompetencat e Ortakut të Vetëm**

8.1 Ortaku i Vetëm, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar vetëm në to, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

8.2 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen sipas rendit kronologjik në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen. Vendimet e paregjistruara në këtë regjistër janë të pavlefshme. Administratori/ët e Shoqërisë janë përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Vendimeve.

### **Neni 9 - Administrimi i Shoqërisë**

9.1 Administratorët e parë të Shoqërisë janë:

- a. Z. Artion Gani, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 28.11.1978, mbajtës i letërnjoftimit nr.032474096, me adresë në: Rruga e Çerçiz Topulli, pallati AK, nr. 4, Tiranë.



9.2 Administratorët emërohet me vendim të Ortakut të Vetëm dhe do të qëndrojnë në detyrë për një afat 5 vjeçar. Administratorët mund të rizgjidhen për të njëjtin afat në bazë të vendimit të Ortakut të Vetëm ose në përputhje me dispozitat ligjore.

### Neni 10 - Ligji i Zbatueshëm

10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

10.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë aktivitetit të Shoqërisë, do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes pranë Gjykatës kompetente të Rrethit Gjyqësor.

10.3 Ky Akt Themelimi është hartuar në dy ekzemplarë në gjuhën shqipe, më vlerë të njëjtë secila.

Nënshkruar nga Ortakut i Vetëm sot më datë 3 Gusht 2021.

Z. Julian Guko

